

Workshop "Format e kredidhënies" në bashkëpunim me Raiffeisen BANK

Bordi Këshillimor i Biznesit pranë UE-së dhe Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t, po shërbejnë si nxitësit kryesorë në krijimin e mundësive për zhvillimin akademik dhe profesional, përmes marrëveshjeve të ndryshme me institucionet publike dhe private.



Në kuadër të këtij bashkëpunimi me Raiffeisen Bank, u organizua workshopi me temë "Format e kredidhënies", ku në fokus ishin: njohja e studentëve me funksionet, detyrat dhe praktikat e sistemit bankar. Z.Armand Xhavo, ekspert i kredidhënies dhe njohës i mirë i sistemit bankar, prezantoi për studentët te gjitha mundësitë që ofron banka në mbështetjen akademike dhe profesionale të tyre.

